

Data 22.06.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje goma, vaj, antifrizë, graso dhe alkool për automjete” ndare ne lote;

Loti i I-rë: **“Blerje goma”**,

Loti i II-të **“Blerje vaj, antifrizë, graso dhe alkool për automjete”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Goma për automjete të rënda/lehta 34350000-5, 24951100-6 Lubrifikantët.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 11,109,960 (njëmbëdhjetë milion e njëqind e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë, pa TVSH.

1. Loti i I-rë: **“Blerje goma”** me fond limit 7,869,500 (shtatë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

2. Loti i II-të **“Blerje vaj, antifrizë, graso dhe alkool për automjete”** me fond limit 3,240,460 (tre milion e dyqind e dyzet mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Posta Shqiptare sh.a., ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

LOTI I I-RË: “BLERJE GOMA”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të lotit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

(Për sa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për më shumë se një lot, ai duhet të plotësojë kërkesën për xhiron vjetore në raport me vlerën e përllogaritur mbi shumatoren e fondeve limit të loteve për të cilat konkurron. Në këtë rast, vlera e xhiros së realizuar në të paktën një nga vitet financiare të kërkuara duhet të jetë jo më e vogël se vlera e kërkuar për shumatoren e loteve për të cilat paraqet ofertë, me qëllim provimin e kapacitetit të tij ekonomik dhe financiar për realizimin me sukses të të gjitha loteve)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kontratës që prokurohet, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP dhe pikës 4 të nenit 54 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar me Vendimin Nr.545, datë 4.9.2024). Pika 4: [..Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave..] dhe Gërmës c) [..40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme..] dhe të nenit 43 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar me Vendimin Nr.545, datë 4.9.2024) si dhe nenin përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të **Ligjit nr.29/2023**“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Shënim: Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikuar.

(Për sa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për më shumë se një lot, ai duhet të provojë se ka realizuar furnizime të mëparshme të ngjashme gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se vlera e kërkuar për shumatoren e loteve për të cilat paraqet ofertë, me qëllim provimin e kapacitetit të tij teknik për realizimin me sukses të të gjitha loteve ku aplikon)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që mallrat e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më pak se 19 % të vlerës e **fondit limit të lotit për të cilët konkurron**, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

a) **ISO 9001:2015** “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”/ ose ekuivalent

b) **ISO 14001:2015** “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit”/ ose ekuivalent

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprahe.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 79 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Nëpërmjet këtyre certifikimeve kërkohet të provohet se operatorët ekonomikë disponojnë kapacitetet organizative, teknike dhe operacionale të nevojshme për realizimin e kontratës, në përputhje me standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë, sigurisë së informacionit dhe menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

- **Certifikimi ISO 9001:2015 ose ekuivalent** parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.
- **ISO 14001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit”/ ose ekuivalent** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001: me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë mbi garancinë e gomave, ku garancia e tyre në bazë të kilometrazhit të përshkruar në shfrytëzim normal sipas kushteve teknike të shfrytëzimit do të jetë jo më pak se 40.000 (dyzet mijë) km për gomat e automjeteve

Operatori ekonomik i shpallur fitues gjatë periudhës së garancisë është i detyruar të kryejë zëvendësimin e gomave me difekt për shkak të prodhimit ose cilësisë së dobët, pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Kërkesa për garanci të gomave është vendosur për të siguruar cilësinë, sigurinë dhe jetëgjatësinë funksionale të mallrave të furnizuara, si dhe për të mbrojtur

interesin ekonomik të Autoritetit Kontraktor. Gomat janë element kritik për sigurinë e qarkullimit dhe për vazhdimësinë e shërbimeve; defektet e prodhimit ose moskonformitetet teknike mund të shkaktojnë ndërprerje të punës së mjeteve, rrezik për përdoruesit dhe kosto shtesë operative. Garancia e kërkuar detyron operatorin ekonomik të furnizojë produkte që përmbushin specifikimet teknike dhe standardet e cilësisë, si dhe të zëvendësojë ose riparojë pa kosto çdo gomë me defekt që rrjedh nga prodhimi ose materiali, brenda periudhës së garancisë. Kjo kërkesë rrit përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik, ul rrezikun e furnizimit me produkte nën standard dhe siguron performancë të qëndrueshme të mjeteve në shërbim. Kërkesa për garanci është proporcionale me natyrën e kontratës “blerje goma – furnizim dhe vendosje”, lidhet drejtpërdrejt me objektin e saj dhe është e nevojshme për garantimin e përdorimit të sigurt dhe efikas të mjeteve.

*Në çdo rast, për dokumentacionin e përmbushur me **FORMULARIN PËRMBLEDHËS TË VETËDEKLARIMIT**, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor dot t'i kërkojë ofertuesit të vlerësuar në vendin e parë që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike i është referuar standardeve ISO, EN, DIN, SSH, UNI ose standardeve të tjera ndërkombëtare, do të pranohen edhe standarde ekuivalente, të provuara nga operatori ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI I II-TË “BLERJE VAJ, ANTIFRIZE, GRASO DHE ALKOL PËR AUTOMJETE”

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të lotit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

(Për sa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për më shumë se një lot, ai duhet të plotësojë kërkesën për xhiron vjetore në raport me vlerën e përllogaritur mbi shumatoren e fondeve limit të loteve për të cilat konkurron. Në këtë rast, vlera e xhiros së realizuar në të paktën një nga vitet financiare të kërkuara duhet të jetë jo më e vogël se vlera e kërkuar për shumatoren e loteve për të cilat paraqet ofertë, me qëllim provimin e kapacitetit të tij ekonomik dhe financiar për realizimin me sukses të të gjitha loteve)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kontratës që prokurohet, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP dhe pikës 4 të nenit 54 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar me Vendimin Nr.545, datë 4.9.2024). Pika 4: *[..Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave..]* dhe Gërmës c) *[..40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme..]* dhe të nenit 43 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar me Vendimin Nr.545, datë 4.9.2024) si dhe nenin përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të **Ligjit nr.29/2023** “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më

pak se 19 % e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Shënim: Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikuar.

(Për sa më sipër, nëse ofertuesi aplikon për më shumë se një lot, ai duhet të provojë se ka realizuar furnizime të mëparshme të ngjashme gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se vlera e kërkuar për shumatorën e loteve për të cilat paraqet ofertë, me qëllim provimin e kapacitetit të tij teknik për realizimin me sukses të të gjitha loteve ku aplikon)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që mallrat e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më pak se 19 % të vlerës e **fondit limit të lotit për të cilët konkurron**, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

a) **ISO 9001:2015** “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”/ ose ekuivalent

b) **ISO 14001:2015** “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit”/ ose ekuivalent

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 79 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 44 të VKM nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Nëpërmjet këtyre certifikimeve kërkohet të provohet se operatorët ekonomikë disponojnë kapacitetet organizative, teknike dhe operacionale të nevojshme për realizimin e kontratës, në përputhje me standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë, sigurisë së informacionit dhe menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

- **Certifikimi ISO 9001:2015 ose ekuivalent** parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.
- **ISO 14001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit”/ ose ekuivalent** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001: me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

2.3.3 Operatori ofertues duhet të paraqesë raport analizat të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) / raport testimi/skede teknike për vajrat e kërkuar në shtojcën 6, ose nga një laborator i akredituar, ku vlerat e treguesve të analizuar të përputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Raport analiza duhet të jetë lëshuar brenda vitit 2026. Akreditimi të jetë i vlefshëm nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

Në çdo rast, për dokumentacionin e permbushur me FORMULARIN PËRMBLEDHËS TË VETËDEKLARIMIT, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor dot t'i kërkojë ofertuesit të vlerësuar në vendin e parë që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike i është referuar standardeve ISO, EN, DIN, SSH, UNI ose standardeve të tjera ndërkombëtare, do të pranohen edhe standarde ekuivalente, të provuara nga operatori ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike dhe termave të referencës

Specifikimet teknike të procedurës për Specifikimet teknike të procedurës për “**Blerje goma, vaj, antifrizë, graso dhe alkool për automjete**”, janë hartuar mbi bazën e **Urdhërit Nr. 26**, datë **19.03.2026**, të Administratorit të Posta Shqiptare sh.a., në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar).

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Termat e Referencës për procedurën me objekt “Blerje goma, vaj, antifrizë, graso dhe alkool për automjete” përcaktojnë kërkesat funksionale dhe teknike për sigurimin e furnizimit me materiale konsumi për automjetet e Autoritetit Kontraktor. Qëllimi i kontratës është garantimi i furnizimit të vazhdueshëm me produkte cilësore, të përshtatshme për përdorim në automjete, në funksion të mirëmbajtjes dhe funksionimit normal të flotës. Mallrat duhet të jenë të reja, të papërdorura, në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare të cilësisë dhe të shoqërohen me dokumentacion që vërteton origjinën dhe përputhshmërinë teknike. Furnizimi do të realizohet sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor gjatë periudhës së kontratës, me dorëzim në vendin e përcaktuar prej tij dhe brenda afateve të kërkuara.

Operatori ekonomik është përgjegjës për garantimin e përputhshmërisë së mallrave me specifikimet teknike dhe për zëvendësimin e çdo produkti të konstatuar jo në përputhje gjatë pranimit ose përdorimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Vlera Limit e kontratës, duke qenë se nuk ka çmime të botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse, grupi i punës i ngritur me urdhërin e administratorit nr. 34, datë 20.04.2026, u bazua në çmimet e tregut, e bazuar në nenin 76

“Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar) ku parashikohet se:

1. Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
- b) **studimit të tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Bazuar në germen b) të pikës 1, të nenit 76 “Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar), grupi i punës, ka realizuar **studimin e tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; dokumentacion i cili gjendet në dosjen e tenderit dhe ka përlogaritur vlerën limit të kontratës.

Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta për kualifikim janë hartuar nga strukture e posacme e ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor.

Njësia e Prokurimit: